REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

**VENDIM**

**Nr 6 , Datë 22. 05. 2013**

**Për**
**Miratimin e projekt-zbatimit për "Rehabilitimin e digave ekzistuese Thanës, Kurjan - Strum e Zharrëz ".**

Në zbatim të pikës dh. neni 4. kreu II. të ligjit nr.8681. datë 02.11.2000. "Për projektimin. ndërtimin. shfrytëzimin. dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave". neni 9. 13. të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave". Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD). me kërkesë të Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.2021 prot. datë 26.04.2013 në mbledhjen e datës 26. 04. 2013. mori në shqyrtim projekt-zbatimin për "Rehabilitimin e digave ekzistuese Thanës. Kurjan e Strum dhe Zharrës " nga projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes. i financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare.

Mbasi u prezantua projekt-zbatimi nga përfaqësuesit e grupit të projektimit Mott MacDonald në datë 26.04.2013. Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha pasi diskutoi lidhur me projekt-zbatimin e digave ekzistuese të Thanës. Kurjan - Strum e Zharrëz :

## Vendosi:

Të miratojë projekt-zbatimin për "Rehabilitimin e digave ekzistuese":

**Për Thanën,**
Varianti me nivel uji të ulur dhe vetëm për nevoja të bujqësisë.
**Për Zharrzën,**
Variantin me shkarkues të lehtësuar.
**Për Kurjan dhe Strum,**
Sipas projektit të paraqitur në KKDM.

Me respekt,

**PERI DISHNICA**

**KRYETAR**